



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 292/ Prot

Elbasan, më 6.3.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.19, datë 26.02.2025 “Për miratimin e raportit për vlersimin dhe parashikimin e Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit të vitit 2026 të të ardhurave vendore”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI
Ilir BEJTJA

292
03.3.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.28.02.2025

Nr. 1205 prot

Nr.19 dt.26.02.2025

“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR VLERËSIMIN DHE PARASHIKIMIN E BUXHETIT AFATMESM 2026-2028 DHE BUXHETIT TË VITIT 2026 TË TË ARDHURAVE VENDORE”

Në zbatim ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 9936 datë. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr. 9632 datë 30.10.2006 « Për Sitemin e Taksave Vendore » i ndryshuar , Ligji Nr .9920 , datë 19.05.2008 » Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë « i ndryshuar, Ligjit Nr. 68 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Neni. 34 Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave. Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.100, datë 27.11.2024 “ Paketa Fiskale 2025“ miratuar nga Prefekti i Qarkut me Nr.1301/1, datë 13.12.2024 ,Udhëzimi i Ministrisë së Financave “ Për Proçedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afat mesem “ , Urdhëri i Kryetarit Bashkise “ Mbi ngritjen e grupit per hartimin e Projekt – Buxhetit afat mesem 2026 – 2028 dhe buxheti vjetor 2026”, është bërë parashikimi i të ardhurave afatmesme Këshilli Bashkiak I mbledhur sot më date 26.02.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

V E N D O S I:

1-Të miratojë raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për:

- a) Dy vitet para vitit buxhetor ,vitet 2023 - 2024
- b) Vitin buxhetor 2025.
- c) Tre vitet e ardhshme buxhetore 2026-2028 (sipas tabelës Nr. 1 bashkëngjitur projekt-vendimit)

2 Ndjek zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e te Ardhurave Vendore.,Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar .

3- Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT
Silvana HOXHA



BASHKIA LIBRAZH
DREJTORIA E TE ARDHURAVE VENDORE

Data më, 14.02. 2025

VLERËSIMI I TË ARDHURAVE PËR BUXHETIN AFATMESËM 2026-2028
Njësia e Vetëqeverisjes Vendore

2128001

/ 000 LEKE

Nr	Llojio i takses e tarifes	Realizimi Viti 2023	Realizimi Viti 2024	Plani Viti 2025	Planifikimi Viti 2026	Planifikimi Viti 2027	Planifikimi Viti 2028
	<i>Te ardhura tatimore</i>						
	<i>Te ardhura nga taksat vendore</i>						
1	Tatim i thjeshtuar mbi biz e vogel	90	241	350	357	364	371
2	Taksa nga tatimi mbi te ardhurat personale	12,207	13,630	12,000	13,000	13,500	13,770
3	Taksa mbi ndertesat	12,425	16,610	14,500	20,000	20,400	20,808
4	Takse mbi truallin	655	623	650	700	750	765
5	Takse toke bujqesore	2,597	2,663	5,559	5,559	5,559	5,670
6	Taksa e kalim te drejtes se pronesisë	956	340	250	255	260	265
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nderitimet e reja	2,690	9,145	20,000	20,400	20,500	20,910
8	Taksa e ndikimit ne infrastrukture legalizimet	3,710	2,538	15,000	15,300	15,400	15,708
9	Takse tabele	330	485	500	500	550	561
10	Takse hoteli	105	168	350	380	400	408
11	Taksa e regjistrimit pervitshem te automjeteve	13,458	15,321	15,000	15,300	15,086	15,388
12	Takse nga Renta	110	139	150	153	160	163
		49,333	61,903	84,309	91,904	92,929	94,788
	Te ardhura jo tatimore						
	Te ardhura nga tarifat vendore						
1	Tarife pastrimi	17,551	22,174	23,000	23,500	24,000	24,480
2	Tarife ndricimi+Gjelbrimi	2,624	3,777	3,700	3,800	3,850	3,927
3	Tarife sherbimi ne varrezat publike	120	150	190	190	190	194
4	Tarifa e sherbimit veterinar	200	350	300	360	370	377
5	Tarife e tregut te organizuar	1,081	1,038	1,300	1,326	1,353	1,380

6	Tarifa leje per tregetim ambulator	31	33	39	40	42	43
7	Tarife parkimi	1,453	1,311	1,353	1,380	1,408	1,436
8	Tarife per dhenie license e certificate transporti	703	461	310	316	320	326
9	Tarife per leje te drejta , vertetime,informacione	97	77	200	204	208	212
10	Tarife per zenien e hapsires publike	1,900	2,420	2,260	2,300	2,400	2,448
11	Tarife per librat e udhetimi te udhetareve brenda vendit	112	37	100	130	150	153
12	Tarifa per autorizime ushtim aktiviteti, autorizime per karburantet.	1,400	1,800	3,000	3,100	3,200	3,264
13	Tarifa te tjera nga Urbanistika	554	573	3,000	3,060	3,100	3,162
14	Tarife per linjat ajrore dhe nentokesore	430	430	430	439	447	456
15	Tarife per mbetjet inerte	4	-	15	15	15	15
16	Tarifa për ndikimin ne mjedis	5,778	6,189	7,283	7,429	7,577	7,729
17	Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.	71	107	120	130	140	143
18	Kamatvonesa	1,728	940	1,000	1,200	1,300	1,326
19	Detyrimi i prapambetur nga taksat	15,337	8,631	19,600	20,000	20,400	20,808
	Shuma	51,174	50,498	67,200	68,919	70,470	71,879
1	Tarifa ne sektorin e pyjeve dhe kullotave						
1	Tarifa ne Sektorin e Pyjeve	16,820	15,763	28,000	28,000	28,000	28,560
2	Tarifa ne Sektorin e Kullotave	209	845	800	800	800	816
3	Tarifa nga shfrytëzimi i materialit drusor nga subjektet	14,490	4,317	18,900	19,000	19,000	19,380
4	Nga shfrytëzimi I druve te zjarrit nga fshataresia	2,583	1,565	5,000	5,200	5,400	5,508
5	Nga shfrytëzimi I prodhimeve te dyta pyjore, te tjera	251	97	300	300	300	306
6	Te ardhura nga perdorimi vertetimeve te transportit kamate vonese dok. Ankandi rap teknik eji	446	258	500	550	600	612
7	Te ardhura nga shitja e materialit drusor qe dalin nga trallimet	-	-	200	200	200	204

	Shuma	34,799	22,845	53,700	54,050	54,300	55,386
	Te ardhura te tjera						
1	Qera e shitje trualli	357	467	472	472	472	481
2	Qera ndertese , qera ndertese nga privatizimet	469	1,483	2,400	2,500	2,600	2,652
3	Pagesa e prinderve cerdhe	1,515	4,857	9,200	9,300	9,400	9,588
4	Pagesa e prinderve kopesht	5,033	801	1,424	1,424	1,424	1,452
5	Detyr:te prapamb.nga kopshtet cerdhe dhe gendra ditore	317	53	1,650	1,750	1,850	1,887
6	Gjoha nga IMT ,dhe Policia Bashkiake	185	24	30	30	30	31
7	Te ardhura nga pullat e gjendjes civile 5 %	26	18,645	-	-	-	-
8	Sponsorizime	8,016	-	-	-	-	-
9	Tarife akte ligjore e administrative, shitje skrap etj	18		-		-	-
	Shuma	15,936	26,330	15,176	15,476	15,776	16,092
	TOTALI	151,242	161,576	220,385	230,349	233,475	238,145



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E TE ARDHURAVE VENDORE

Librazhd më, 14.02.2025

RELACION

**“PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT PËR VLERËSIMIN DHE PARASHIKIMIN E BUXHETIT
AFATMESM 2026-2028 DHE BUXHETIT TË VITIT 2026 TË TË ARDHURAVE
VENDORE”**

Të nderuar Këshilltarë :

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 « Për Sisemin e Taksave Vendore » i ndryshuar ,Ligji Nr. 9920 , datë 19.05.2008 » Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë « i ndryshuar , Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.100,datë 27.11.2024 “ Paketa Fiskale 2025 “, Ligjit nr. 68 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Neni 34 ,37, Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave, Udhezimi i plotësues Nr. ___ datë ___/02.2025 “ Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor për vitet 2026 - 2028 .

Është bërë parashikimi i të ardhurave afatmesme për:

- a) dy vitet para vitit buxhetor 2023-2024
- b) vitin buxhetor 2025
- c) tre vitet e ardhshme buxhetore 2026-2028.

Njësia e vetëqeverisjes vendore mbështetet në udhëzimin përkatës të Ministrisë të Financave. Buxheti për tre vitet e ardhshme ka në qendër, rritjen e të ardhurave, rritjen e shërbimeve, rritjen e aksesit dhe të cilësisë së jetës nga qyteti deri në skajet më të largëta të Bashkisë Librazhd . Vizioni ynë është që të krijojmë një sistem që nxit transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në mbledhjen, administrimin dhe përdorimin e burimeve financiare për shërbime më të mira dhe zhvillim të mëtejshëm ekonomik. Parashikimi i buxhetit afatmesëm për Bashkinë Librazhd në tre vitet e ardhshme është i mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapaciteteve reale të taksave e tarifave, në ecurinë e realizimit të tyre në vite si dhe politikat e përcaktuara për vitet pasardhëse, duke u mbështetur në legjislacionin aktual në fuqi. Këto parashikime mbështeten në llogaritjet e përgjithshme që janë të lidhura ngushtë me masat që pritet të ndërmerren nga administrata tatimore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë, por dhe jashtë saj, për realizimin e parashikimeve të pretenduara të të ardhurave.

Parashikimi i të ardhurave për periudhën afatmesme parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore duke forcuar kapacitetet administruese, duke zgjeruar bazën e taksapaguesve si dhe duke marrë në konsideratë :

a) Përpjekjet për të forcuar menaxhimin e të ardhurave, për të rritur efikasitetin e tyre në mbledhjen e të ardhurave, zvogëluar hendekun tatimor, luftuar evazionin fiskal dhe **ekonominë informale**.

b) Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet dhe familjarët.

c) Nxitja e bizneseve të reja , bizneset që administrohen nga vajzat e djemte si dhe bizneset e reja me aktivitet agroturizem , prodhime bujqesore , guida , kamping hiking duke krijuar lehtësira në tarifim.

ç) Ecurinë e realizimit të të ardhurave për faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve.

Të ardhurat e parashikuara për vitet 2026-2028

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara,. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme. Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Librazhd

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë :

a)taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to;

b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;

c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier;

ç) taksa e tabelës;

d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël;

e) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

Tarifat Vendore

Tarifat vendore përfshijnë tarifat për:

a) tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike ;

b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve , pastrimi.

c) tarifa për ndriçim gjelberim ;

ç) tarifa për përmiresimin e mjedisit ;

d) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënien e licencave, lejeve e autorizimeve;

dh) tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara në ligj;

e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore;

ë) tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj.

Të Ardhura të Tjera të Veta

a)Të ardhurat e tjera përfshijnë ato të gjeneruara nga: pozicionet aksionare të bashkisë;

b)ndëshkimet dhe gjobat;

c)grante nga marrëveshjet ndërkombëtare apo nga qeveritë e huaja; etj.

Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga:

- a) tatimi mbi të ardhurat personale,
- b) taksa e regjistrimit të automjeteve
- c) renta minerale.
- ç) Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë.

Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera.

Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është pjesë e taksave të ndara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përftojnë 25% të të ardhurave totale të gjeneruara nga kjo taksë.

Renta Minerare, çdo person fizik ose juridik, i cili është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për këtë fushë, duhet të paguajë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi/nën tokën e Republikës së Shqipërisë. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ku kryhet aktiviteti marrin 5 përqind e të ardhurave nga renta minerare.

Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme (97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë).

Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për dy vitet para buxhetore 2023, 2024 është vendosur fakti i të ardhurave të realizuara që tregon rritje të të ardhurave në vlerë 10,333 mijë lekë ose 6.83% me shumë në vitin 2024.

Për vitin buxhetor 2025 jemi referuar planifikimit të buxheti sipas VKB Nr 108, date 27.12.2024 e konfirmuar nga qarku .PBA 2026-2028 sipas zerave si me poshte :

Për tre vitet e ardhshme buxhetore 2026-2028 nuk janë paraqitur ndryshime për 2026,2027 , janë sipas buxhetit të miratuar me Nr. 108 , datë 27.12.2024 “ “ Per miratimin e Buxhetit 2025 “ Per parashikimin e buxhetit 2028 kemi një planifikim të ardhurash në masën rreth 2 % sipas tabelës së mëposhtme.

Vlerësimet dhe Parashikimet afatmesme të të ardhurave të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore për vitin 2026 – 2028.

Tabela Nr 1

/ 000 lekë

Nr	Lloji i takses e tarifës	Realizimi Viti 2023	Realizimi Viti 2024	Plani Viti 2025	Planifikimi Viti 2026	Planifikimi Viti 2027	Planifikimi Viti 2028
	<i>Te ardhura tatimore</i>						
	<i>Te ardhura nga taksat vendore</i>						
1	Tatim i thjeshtuar mbi biz e vogel	90	241	350	357	364	371
2	Taksa nga tatimi mbi të ardhurat personale	12,207	13,630	12,000	13,000	13,500	13,770
3	Taksa mbi ndertesat	12,425	16,610	14,500	20,000	20,400	20,808

4	Takse mbi truallin	655	623	650	700	750	765
5	Takse toke bujqesore	2,597	2,663	5,559	5,559	5,559	5,670
6	Taksa e kalim te drejtes se pronesise	956	340	250	255	260	265
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukture ndertimet e reja	2,690	9,145	20,000	20,400	20,500	20,910
8	Taksa e ndikimit ne infrastrukture legalizimet	3,710	2,538	15,000	15,300	15,400	15,708
9	Takse table	330	485	500	500	550	561
10	Takse hoteli	105	168	350	380	400	408
11	Taksa e regjistrimit pervitshem te automjeteve	13,458	15,321	15,000	15,300	15,086	15,388
12	Takse nga Renta	110	139	150	153	160	163
		49,333	61,903	84,309	91,904	92,929	94,788
	Te ardhura jo tatimore						
	Te ardhura nga tarifat vendore						
1	Tarife pastrimi	17,551	22,174	23,000	23,500	24,000	24,480
2	Tarife ndricimi+Gjelbrimi	2,624	3,777	3,700	3,800	3,850	3,927
3	Tarife sherbimi ne varrezat publike	120	150	190	190	190	194
4	Tarifa e sherbimit veterinar	200	350	300	360	370	377
5	Tarife e tregut te organizuar	1,081	1,038	1,300	1,326	1,353	1,380
6	Tarifa leje per tregetim ambulator	31	33	39	40	42	43
7	Tarife parkimi	1,453	1,311	1,353	1,380	1,408	1,436
8	Tarife per dhenie license e certifikate transporti	703	461	310	316	320	326
9	Tarife per leje te drejta ,	97	77	200	204	208	212

	vertetime,informacione						
10	Tarife per zenien e hapsires publike	1,900	2,420	2,260	2,300	2,400	2,448
11	Tarife per librat e udhetimi te udhetareve brenda vendit	112	37	100	130	150	153
12	Tarifa per autorizime ushtrim aktiviteti, autorizime per karburantet.	1,400	1,800	3,000	3,100	3,200	3,264
13	Tarifa te tjera nga Urbanistika	554	573	3,000	3,060	3,100	3,162
14	Tarife per linjat ajrore dhe nentokesore	430	430	430	439	447	456
15	Tarife per mbetjet inerte	4	-	15	15	15	15
16	Tarifa për ndikimin ne mjedis	5,778	6,189	7,283	7,429	7,577	7,729
17	Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.	71	107	120	130	140	143
18	Kamatvonesa	1,728	940	1,000	1,200	1,300	1,326
19	Detyrimi i prapambetur nga taksat	15,337	8,631	19,600	20,000	20,400	20,808
	Shuma	51,174	50,498	67,200	68,919	70,470	71,879
	Tarifa ne sektorin e pyjeve dhe kullotave						
1	Tarifa ne Sektorin e Pyjeve	16,820	15,763	28,000	28,000	28,000	28,560
2	Tarifa ne Sektorin e Kullotave	209	845	800	800	800	816
3	Tarifa nga shfrytezimi i materialit drusor nga subjektet	14,490	4,317	18,900	19,000	19,000	19,380
4	Nga shfrytezimi I druve te zjarrit nga fshataresia	2,583	1,565	5,000	5,200	5,400	5,508
5	Nga shfrytezimi I prodhimeve te dyta pyjore, te tjera .	251	97	300	300	300	306

6	Te ardhura nga perdorimi vertetimeve te transportit kamate vonese dok. Ankandi rap teknik etj	446	258	500	550	600	612
7	Te ardhura nga shitja e materialit drusor qe dalin nga rrallimet	-	-	200	200	200	204
	Shuma	34,799	22,845	53,700	54,050	54,300	55,386
	Te ardhura te tjera						
1	Qera e shitje trualli	357	467	472	472	472	481
2	Qera ndertese , qera ndertese nga privatizimet	469	1,483	2,400	2,500	2,600	2,652
3	Pagesa e prinderve qerdhe	1,515	4,857	9,200	9,300	9,400	9,588
4	Pagesa e prinderve kopesht	5,033	801	1,424	1,424	1,424	1,452
5	Detyr.te prapamb.nga kopshtet cerdhe dhe qendra ditore	317	53	1,650	1,750	1,850	1,887
6	Gjoba nga IMT ,dhe Policia Bashkiake	185	24	30	30	30	31
7	Te ardhura nga pullat e gjendjes civile 5 %	26	18,645	-	-	-	-
8	Sponsorizime	8,016	-	-	-	-	-
9	Tarife akte ligjore e administrative, shitje skrap etj	18		-		-	-
	Shuma	15,936	26,330	15,176	15,476	15,776	16,092
	TOTALI	151,242	161,576	220,385	230,349	233,475	238,145

Vlerësimet e të ardhurave për vitet 2023 - 2024 dhe parashikimet Afat Mesme për vitet 2026 - 2028 i argumentojmë si më poshtë :

Për vitin 2023 dhe 2024 është vendosur realizimi faktik i të ardhurave për taksa e tarifa vendore
Për vitin 2028 eshte parashikuar rritje 2 % ,per arsyen se ne rregjistrin e taksapaguesve do te futen te gjitha pronat kjo sipas iniciativave dhe vendimeve per pronen . Per vitin 2028 kemi vlerësuar një parashikim / rritje rreth 2 % të të ardhurave në zërin e tarifave dhe të taksave nga parashikimi i shtimit te bazës së taksueshme si për bizneset ashtu dhe për familjaret dhe informalizimi i bizneseve .

Vlen të theksojmë se gjatë viteve të kaluara, paketave fiskale respektive u janë bërë ndryshime thelbësore të cilat kanë pasur në fokus të lehtësojnë barrën për biznesin, përmirësimin e standartit të ofrimit të shërbimeve, përmirësimin e kushteve për një qytet të pastër, miqësor dhe ka ç'të ofrojë në çdo muaj të vitit.

Struktura e të Ardhurave për vitin buxhetor 2025 dhe për vitet 2026 – 2027- 2028 .

në mijë lekë					
Nr	Taksa e Tarifa Vendore	Planifikimi Viti 2025	Parashikimi Viti 2026	Parashikimi Viti 2027	Parashikimi Viti 2028
1	Të ardhura nga taksat	84,309	91,904	92,929	94,788
2	Të ardhura nga tarifat	67,200	68,919	70,470	71,879
3	Të ardhura nga sek pyjeve e kullotave	53,700	54,050	54,300	55,386
4	Të ardhura të tjera	15,176	15,476	15,776	16,092
	Totali	220,385	230,349	233,475	238,145

Bashkëngjitur Projekt - Vendimit në format exeli po ju vëmë në dispozicion tabelën me parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2026-2028.

Në përfundim të këtij relacioni mendojmë se vlerësimi dhe parashikimi i të ardhurave afatmesme 2026-2028 do të jetë faktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe përmbushjen e funksioneve të Bashkisë ndaj komunitetit.

Duke shpresuar në miratimin tuaj!

DREJTORE E ARDHURAVE VENDORE

Lindita Shuli

